



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

## NJOFTIM PËR PUNËSIM

Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Q.S.U "Nënë Tereza" kërkon të punësojë **1 (një) Drejtor pranë Drejtorisë Juridike**, në QSU "Nënë Tereza"

### **Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët janë:**

- Arsimi i lartë, profil Juridik në nivelin Master Shkencor. *Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;*
- Të paktën 3 vite pune në nivel drejtues;
- Të njoh shumë mirë procedurat administrative;
- Njohuri të gjera të kuadrit ligjor në fuqi në përgjithësi e veçanërisht të prokurimeve publike si dhe të përfaqësimit në proçese gjyqësore;
- Aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritete dhe respektuar afatet; aftësi për të planifikuar, rishikuar dhe drejtuar punën e stafit nën varësi.
- Aftësi dhe fleksibilitet në përditësimet e proçedurave të reja konform ndryshimeve ligjore
- Aftësi shumë të mira komunikimi.

### **Për sa më sipër, personat e interesuar duhet të dorëzojnë:**

1. Kërkesa me shkrim e shoqëruar me fotokopje e dokumentit të identifikimit (ID)
2. Curriculum vitae (CV) (në gjuhën shqipe)
3. Diplomën/at e arsimit të lartë, të noterizuar/a
4. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)
5. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore  
(<http://www.qsut.gov.al/rreth-nesh-8/te-punosh-me-ne/procedurat-e-marrjes-ne-pune-ne-qsut/>)
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në CV dhe që lidhen me pozicionin për të cilin aplikon.

Depozitimi i aplikimeve do të bëhet pranë zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e QSU "Nënë Tereza" duke nisur nga data **09.09.2021 ora 08:00** deri më **23.09.2021 ora 16:30**.

Komunikimi për datën dhe orën e Intervistave do të bëhet nëpërmjet **e-mail**-it në CV e kandidatëve.

Të gjithë kandidatët fitues do të rivlerësohen në fund të kontratës 3 (tre) mujore.

**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**